

Në të gjitha shkollat fillore të qytetit Vantaa fillon semestri vjeshtor me mësimëdhënie në klasë

Instituti për shëndetësi dhe mirëqenie, ministria për arsim dhe kulturë si dhe Bordi Qendror i Arsimit kanë hartuar udhëzimet gjithëpërfshirëse për kthimin në aktivitetin shkollor, të cilat duhet të zbatohen nëpër shkollat e qytetit Vantaa. Ne i ndjekim në mënyrë aktive udhëzimet zyrtare shtetore.

Kështu synojmë për të siguruar mësimëdhënie të sigurtë nëpër shkolla

- **Nxënësi nuk mund të vijë në shkollë, nëse ka simptoma sado të pakta në frymëmarrje, temperaturë apo ndjenja tjera të sëmundjes.**
- Në shkollë duhet kujdesur për higjienën e mirë për duar dhe kollitje.
- Synohet kufizimi i aktivitetit shkollor në njësi më të vogla bazuar në mundësitë që ka shkolla. Lëvizja e nxënësve orientohet nëpër hyrje-dalje të ndryshme. Synohet të arrihet, që njësitë të mos bashkohen njëra me tjetrën, por brenda njërive mund të ketë aktivitete të përbashkëta duke ruajtur distancën e duhur.
- Orari ditor i punës përshtatet, ashtuqë të shmanget lëvizja masive në kohë të njëjtë sikurse në pushimin në mes të orëve ashtu edhe gjatë arritjes në shkollë dhe largimit prej saj.
 - Klasët 1.-6. munden të mbajnë mësimin nga ora 8 deri në 16
 - Klasët 7.-9. munden të mbajnë mësimin nga ora 8 deri në 17
- Orari i ushqimit dhe hapësirat lidhur me shërbimin e ushqimit synohet të jenë mundësishtë sa më të ndara dhe të sigurt nga ana higjienike.
- Në shkollë nuk organizohen tubime të drejtëpërdrejta masive të përbashkëta, por mund të organizohen tubime nga vetë klasa/grupi/njësia.
- Duhet të shmanget qëndrimi në zonën e shkollës për persona tjerë përveç nxënësve dhe personelit të shkollës gjatë kohës sa zgjatë mësimi.
- Janë në fuqi rregullat normale të pushimit mjekësor. Kërkohe nga ata që ju takojnë grupeve me rrezikshmëri nga infeksioni të jenë në kontakt me drejtorin e shkollës.
- Ata që kthehen nga udhëtimet e bëra jashtë Finlandës duhet të zbatojnë rekomandimet në fuqi të këshillit shtetror lidhur me secilin nga ato vende për të cilat vlenë kufizimi i udhëtimit. Rekomandohet mbajtja vullnetare e karantinimit për 14 ditë pas kthimit nga vendet ndaj të cilave vlenë kufizimi i udhëtimit.

Ju urojmë një vjeshtë të plotësuar me mësimëdhënie të sigurtë!